



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

C.nr.8866/2023

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil**, me gjyqtarin Hysni Ismaili, në çështjen juridike të paditëses B. K. nga P., me numër personal 1....., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T. I., avokat nga P., Rruga 'S. K.', nr.3-H., komuna e P., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve 'S...', me seli në P.. lagjja K., K. R., Hyrja Z., Magjistratja P.- Sh., me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material, jashtë seancës gjyqësore me datë 30.04.2024 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia**

**REFUZOHET** kërkesëpadia e paditëses B. K. nga P., me të cilin ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve 'S.', me seli në P., që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të pësuar si pasojë e aksidentit të trafikut i cili ka ndodh me datë 05.11.2023:

Dëmi jo material:

- kompensim, në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike.
- kompensim, në emër të frikës së përjetuar.
- kompensim, në emër të zvogëlimit të aktivitetit punues.
- kompensim, në emër të shëmtimit.

Dëmi material:

- kompensim, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj.
- kompensim, në emër të ushqimit të përforcuar.
- kompensim, në emër të trajtimit fizikal.
- kompensim në emër të shpenzimeve mjekësore.

me kamatë ligjore prej 8%, t'i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim nën kërcënim të përmbarrimit forcërisht, **Si e pabazuar.**

## **A r s y e t i m**

Paditësja B. K., përmes të autorizuarit të saj ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve 'S.', në P., me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material.

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me parashtrësën e datës 17.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se heq dorë nga padia dhe kërkesëpadia, meqenëse me të paditurën ka arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensim dëmi dhe paditësja është kompensuar.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia e paditëses, konstatoi se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët mund të disponojnë lirshëm, në kuptim të nenit 149 paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se *“paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heq dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi”* (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë) – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.8866/2023 datë 30.04.2024**

**Gjyqtari**  
**Hysni Ismaili**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.